



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1024/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi Kryesues, Ferki Xhaferi dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Demë Avdijaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Gjakovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.1024/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Demë Avdijaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Gjakovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në qendrën 0219C/02R.

#### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Demë Avdijaj nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Gjakovë, në të cilën thekson se në qendrën 0219C/02R me datën 17.10.2021 ka të afërt që kanë votuar, me konkretisht thekson se, Familja Lekaj me ka votuar, por se i njëjti thekson se nuk i ka rezultuar asnjë votë, andaj kërkon rinumërim të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar ndonjë provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në

kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli nuk mund të konstatoj se ka pasur mungesë të votave për kandidatin në fjalë, për faktin se thëniet e tij janë vetëm theksime ne apel te cilat si te tilla ato pretendime janë jo të konkretizuara me asnjë provë konkrete bindëse për atë çfarë pretendon, andaj edhe nuk i ka argumentuar ato për të cilën pretendon.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Demë Avdijaj nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Gjakovë, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi në vendvotimin e lartcekur.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1024/2021 më datën 07.11.2021



**Kryesuese e Panelit**  
**Burim Ademi**

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.